

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)**Buletini Nr. 252/ 2022, 09-09-2022****Parashikimi** nga 09-09-2022, ora 12:00 deri më 10-09-2022, ora 23:59.**PARASHIKIMI METEO****RESHJET**

Sot pasdite (e premte, dt.09) dhe nesër (e shtunë, dt.10) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Shkodër dhe Lezhë, mesatare në qarqet Durrës dhe Tiranë. Në qarqet Kukës dhe Dibër priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta. Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata në qarqet Shkodër, Lezhë, Durrës dhe Tiranë. Në zonat urbane në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, kryesisht në fundin e ditës së sotme dhe pjesën e parë të ditës së nesërme, në varësi të gjendjes së kanalizimeve. Në qarqet Shkodër dhe Lezhë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjëve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

**TEMPERATURAT**

Nesër (e shtunë, dt.10) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 22 / 29 °C

në vendet e ulëta: 22 / 30 °C

në vendet malore: 16 / 27 °C

**ERA**

Sot pasdite (e premte, dt.09) dhe nesër (e shtunë, dt.10) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

**ZJARRET NË PYJE**

Sot pasdite (e premte, dt.09) pritet nivel "I MODERUAR" në qarqet në qendër dhe jug të vendit, ndërsa në qarqet e tjerë niveli "S'KA RREZIK". Nesër (e shtunë, dt.10) pritet niveli "S'KA RREZIK" në të gjithë qarqet (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).



Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: Elona Abazi

Koordinator: Alban Doko ( Tel: +355 69 311 9392, e-mail: [albania.hazards@gmail.com](mailto:albania.hazards@gmail.com))

faqe 1 / 3

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)

Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 252/ 2022, 09-09-2022

Parashikimi nga 09-09-2022, ora 12:00 deri më 10-09-2022, ora 23:59.

NIVELET E RREZIKUT











S'KA RREZIK

I ULËT

I MODERUAR


I LARTË

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
DIBËR	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare					
ELBASAN	I MODERUAR	të dobëta					
FIER	I MODERUAR	të dobëta					
BERAT	I MODERUAR	të dobëta					
KORÇË	I MODERUAR	nuk ka reshje	të dobëta				
VLORË	I MODERUAR	nuk ka reshje	të dobëta				
GJIROKASTËR	I MODERUAR	të dobëta					

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu</b> (mm / 24 orë)
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 09 – 10.****LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**SIMBOLE**

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke